



## Jean Monnet Module

### Financial Aspects of European Integration of Albania - FARINA

Qëllimi i këtij projekti është që nëpërmjet modulit "Aspekte financiare të integrimit evropian" të japë një panoramë të detajuar lidhur me implikimet financiare dhe ndikimin në financat publike që do të shoqërojnë procesin e integrimit evropian të Shqipërisë.

Projekti është projektuar në mënyrë të përshtatshme për të mundësuar dhe siguruar edukim dhe trajnim të vazhdueshëm në fushën e Studimeve Evropiane sipas standardeve të BE-së. Projekti konsiston në zhvillimin e veprimtarive mësimore për modernizimin e arsimit në Shqipërinë e Mesme në fushën e integrimit ekonomik evropian. Këto aktivitete fokusohen në përcaktimin e planprogrameve, konturet e lëndëve, materialet e reja mësimore, krijimin e faqes të internetit dhe trajnimin e grupit të synuar në integrimin ekonomik të BE-së me aktivitete paralele që synojnë përmirësimin e moduleve moderne të BE-së. Aktivitetet në realizimin e projektit do të kontribuojnë në zgjerimin e ideve të integrimit evropian.

Ky projekt është plotësisht në përputhje me objektivin kryesor të programit Jean Monnet: ai promovon përsosmërinë në mësimdhënie dhe kërkime në fushën e Studimeve të Bashkimit Evropian, pajis studentët dhe profesionistët e rinj me njohuri për lëndët e Bashkimit Evropian të rëndësishme për jetën e tyre akademike dhe profesionale dhe rritin aftësitë e tyre qytetare, promovon inovacionin dhe mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe përmirëson cilësinë e trajnimit profesional për temat e BE-së.

Ky projekt do të ketë si synim:

- Nxitjen e ekselencës në mësimdhënie dhe kërkime në fushën e studimeve të Bashkimit Evropian në Shqipëri;
- Rritjen e punësimit dhe perspektivat e përmirësuara të karrierës për të rinjtë e diplomuar, duke përfshirë ose përforcuar një dimension evropian në studimet e tyre;
- Të nxisë dialogun ndërmjet botës akademike dhe shoqërisë, duke përfshirë politikëbërësit në nivel lokal dhe shtetëror, nëpunësit civilë, aktorët e shoqërisë civile, përfaqësuesit e niveleve të ndryshme të arsimit dhe të medias;



- Rritjen e interesit për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në Bashkimin Evropian, duke çuar në një qytetari më aktive;
- Mbështetjen e studiuesve të rinj (të cilët kanë marrë një diplomë doktorature në pesë vitet e fundit) dhe profesorët që dëshirojnë të kryejnë kërkime dhe mësimdhënie mbi temat e BE-së;
- Rritjen e mundësive për stafin akademik në drejtim të zhvillimit profesional dhe në karrierë;
- Gjenerimin e njohurive në mbështetje të politikëbërjes së BE-së;
- Kontaktimi i një publik më të gjerë dhe përhapja njohuritë për BE-në një shoqëri më të gjerë (përtej akademisë dhe audiencës së specializuar) duke e sjellë BE-në më afër publikut.